



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 9/4 prot.

Tiranë, më 12.6 .2018

- Lënda:** Heqje dorë nga ankimi ndaj vendimit nr.04, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për z Sulejman Tola.
- Baza Ligjore:** Neni 4, pika 6 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 44 i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 463 i Kodit të Procedurës Civile.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit.  
Tiranë.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit  
Tiranë.
- Depozituar pranë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit.  
Tiranë.

Të nderuar anëtarë të trupës gjyquese,

pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit është regjistruar çështja nr.3/2018 JR, datë 14.04.2018. Kjo çështje është regjistruar mbi bazën e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr.04, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Sulejman Tola, magjistrat/prokuror.

Z Sulejman Tola është një ndër subjektet e rivlerësimit që ka paraqitur dorëheqjen si magjistrat, sipas parashikimit të Nenit G të Kushtetutës dhe nenit 56 të ligjit nr.84/2016.

Sikundër mund të jeni në dijeni, shkaqet e ankimit ndaj vendimit të mësipërm të Komisionerit Publik lidhen me aspekte procedurale të zbatimit të dispozitave të ligjit nr.84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në harmoni me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioneri Publik edhe në rastin e ankimit të vendimit nr.04, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit z.

Sulejman Tola, magjistrat/prokuror, parashtron shkaqe që lidhen me zbatimin e gabuar të legjislacionit gjatë administrimit, deklarimit dhe rregullimin e pasojave të dorëheqjes së magjistratit për efekt të parashikimeve të nenit G të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016.

Interesi publik në rastet e paraqitjes së dorëheqjeve nga subjektet e rivlerësimit, lidhet ndër të tjera, dhe me zbatimin e ndalimit të parashikuar nga paragrafi i dytë i Nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që sanksionon se subjekti që jep dorëheqjen për shmangur rivlerësimin nuk mund të emërohet gjyqtar, prokuror, anëtar i KLGj-së, KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15 vjeçare.

Ndërkohë, institucioni i Komisionerëve Publikë, nëpërmjet shkresës nr.4030/1 prot., datë 01.06.2018 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*lutem gjeni bashkëlidhur kopje të vërtetuar*), ka rënë në dijeni të faktit se subjektit të rivlerësimit z Sulejman Tola, me vendimin nr.930, datë 10/05/2017 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, i është caktuar pension pleqërie në bazë të ligjit nr.7730, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Përsa kohë z Sulejman Tola, rezulton se ka mbushur moshën për përfitim të pensionit të pleqërisë, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi, ligjërisht është e pamundur, që në çdo rast, ai të mund të emërohet në një nga pozicionet e parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Në të tilla rrethana, duke vlerësuar se:

- i)* shkaqet juridike procedurale, që janë pjesë e ankimit ndaj vendimit nr.04, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin z Sulejman Tola, janë të njëjta dhe do të mund të gjejnë përgjigje nga vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për ankimet të ngjashme që pritet të gjykohen nga kjo gjykatë e nderuar;
- ii)* elementë shumë të rëndësishëm gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit janë eficiency dhe shpejtësia e shqyrtimit të çështjeve nga institucionet përkatëse;
- iii)* respektimi i parimit të ekonomisë gjyqësore, gjen zbatim dhe në procesin gjyqësor përgjatë procesit të rivlerësimit;

në cilësinë e Komisionerëve Publikë, kemi vendosur:

-Heqje dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr.04, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Sulejman Tola, magjistrat/prokuror.

Me respekt,


### KOMISIONERËT PUBLIKË

**Florian BALLHYSA**



**Darjel SINA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA E BURIMEVE TË INFORMACIONIT  
DREJTORIA JURIDIKE  
SEKTORI I LEGJISLACIONIT DHE RREGULLOREVE**

Nr. 4030 prot.  
1

Tiranë, më 01.06.2018

Lënda: Kthim përgjigje

**KOMISIONERIT PUBLIKË**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.09/2 prot, datë 30.05.2018, në të cilën kërkonte informacion nëse z.Sulejman Asllan Tola, ish prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë përfiton pension pleqërie, ju informojmë se:

DRSSH Durrës me Vendim Caktim Pensioni nr.930, datë 10.05.2017, i ka caktuar Z.Sulejman Asllan Tola pension pleqërie në bazë të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në masën 34064 lekë, me datë fillimi 19.02.2017.

Gjithashtu z.Sulejman Asllan Tola i datëlindjes 19.02.1952, në bazë të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit" i ndryshuar, me vendim nr.1, datë 05.06.2017, përfiton edhe pension suplementar në masën 45264 lekë, me datë fillimi 19.02.2017.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Kartelën e Pensionit të Pleqërisë dhe Kartelën e Pensionit Suplementar të z.Sulejman Asllan Tola.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Astrit Hado**



KARTELE PENSIONI SUPLEMENTAR

Tipi i pensionit	Ligji 8097, date 21.03.1996, i ndryshuar (Suplementi shteteror)		
Kodi Karteles	S030002871U	Mbiemri Vajzerise	-
Emri	SULEJMAN	Mbiemri	TOLA
Atesia	ASLLAN	Amesia	SALIJE
Datelindja	19.02.1952	Gjinia	M
PersonID	F20219002J	Gjendja Civile	-
Nr Dosjes	SSHSSH67		
Drssh	Drejtoria Durres	Agjesia	Durres
Dt Fillimit Pensioni	19.02.2017	Dt Kerkese	11.05.2017
Dt Caktimi	05.06.2017	Nr Caktimi	1
Dt Lindje Drejte	19.02.2017	Dt Pageses Fundit	
Qendra Paguese	Credins (DR)	Nr Kartele Pagine	464
		B	
Vjetersia ne pune (lek)	25	9	
Baza Vleresuar (lek)			Totali i te ardhurave (lek) 45,264
Masa fillestare ne (lek)			Paga Neto (lek)
			Masa Aktuale (lek)

e dhena mbi permbajtjen e dosjes se pensionit

Nr	Dokumenti	Dt Fillimi	Dt Mbarimi	Statusi
----	-----------	------------	------------	---------

lement pensioni

Nr.	Emertimi	Masa	Dt Fillimi	Dt Mbarimi
1	Ligji 8097, Pensione shteterore suplementare pleqerie Stok	45,264		
2	Shtesa kreditore	17,578		
3	Shtesa kreditore	17,578		

ndryshimet

Nr.	Emertimi	Nr Vendimi	Dt Vendimi	Vlera Para	Vlera Pas	Ndryshimi	Statusi
-----	----------	------------	------------	------------	-----------	-----------	---------

Inspektori

NEXHMIJE KERTUSHA

Konfirmuesi

ELONA CIPI

Shenime

Rruga Durresit Nr. 83, Tirane, Tel/Fax: 04 227850, e-mail: issh@issh.gov.al, www.issh.gov.al

KARTELE PLEQERIE

Kodi Karteles	P030060895U	Mbiemri Vajzerise	-
Emri	SULEJMAN	Mbiemri	TOLA
Atesia	ASLLAN	Amesia	SALIJE
Datelindja	19-FEB-52	Gjinia	M
PersonID	F20219002J	Gjendja Civile	-
Nr Dosjes	136143		
Drssh	Drejtoria Durres	Agjesia	Durres
Dt Fillimit Pensioni	19-FEB-17	Dt Kerkese	21-MAR-17
Dt Caktimi	10-MAY-17	Nr Caktimi	930
Dt Lindje Drejte	19-FEB-17	Dt Pageses Fundit	
Qendra Paguese	Credins (DR) B	Nr Kartele Pagese	464
Kodi i pensionit	112101		
Vjetersia ne pune	40 .6	Totali i te ardhurve (lek)	34,064
Baza Vleresuar (lek)	62,408	Paga Neto (lek)	0
Masa fillestare (lek)	7,734	Masa Aktuale (lek)	34,064

e dhena mbi permbajtjen e dosjes se pensionit

Nr	Dokumenti	Dt Fillimi	Dt Mbarimi	Statusi
----	-----------	------------	------------	---------

lement pensioni

Nr.	Emertimi	Masa	Dt Fillimi	Dt Mbarimi
1	Pension pleqerise i plote	34064	01.03.2017	
2	Shtesa kreditore	9922	01.03.2017	31.03.2017
3	Shperblim 2017 sipas VKM Nr.745 Dt.13.12.2017	3000	12.12.2017	16.12.2017

ndryshimet

Nr.	Emertimi	Nr Vendimi	Dt Vendimi	Vlera Para	Vlera Pas	Ndryshimi	Statusi
-----	----------	------------	------------	------------	-----------	-----------	---------

Inspektori

DORINA BARDHOSHI

Konfirmuesi

MENDIME JELLA

Shenime NUK ESHTË MARRE NE LLOGARITJE PERIUDHA 28.02.1968-01.04.1969 DREJTORIA E UJRAVE DURRES NGA VERIFIKIMI I BERE PER VJETERSINE NE PUNE REZULTON SE Z.SULEJMAN NUK E KA EMRIN NE REGJISTER THEMELTAR DHE AS NE INDEKS.KETE PERIUDHE NUK E KA TE HEDHU